

BASHKËSIA ISLAME SHQIPTARE “HËNA E RE”

NË KREUZLINGEN

Shkurt: BISH

S T A T U T I

1.0 EMRI, SELIA

- 1.1 Nën emrin “Bashkësia Islame Shqiptare – Hëna e Re” ekziston një shoqatë jofitimprurëse dhe politikisht neutrale, e themeluar në përputhje me nenet 60 e vijues të Kodit Civil të Zvicrës.
- 1.2 Selia e Bashkësisë Islame Shqiptare (BISH) është në Kreuzlingen / TG.

2.0 QËLLIMET, SYNIMET, KOHËZGJATJA DHE VEPRIMTARIA

- 2.1 Qëllimi i BISH në Kreuzlingen është krijimi i një platforme kulturore e fetare si dhe i një vendtakimi për bashkësinë.
- 2.2 Për krijimin e atmosferës së nevojshme të takimit dhe të një niveli të shkëmbimit të mendimeve, BISH mban një qëndrim të qartë, në të cilin përfaqësohet vetëm pozicioni i Islamit mesatar.
- 2.3 Ekstremizmi dhe/ose fanatizmi i çfarëdo forme nuk tolerohen dhe nuk mbështeten nga BISH.
- 2.4 BISH synon integrimin e muslimanëve në qytetin e Kreuzlingenit dhe rrethinën e tij dhe, si anëtare e sas, kontribuon në mënyrë aktive në arritjen e qëllimeve, synimeve dhe filozofisë së Organizatës Islame të Zvicrës Lindore dhe Lihtenshtajnit, e njohur shkurt si DIGO.
- 2.5 BISH angazhohet për promovimin e dialogut ndër fetar dhe do të përpiqet në mënyrë të vazhdueshme të ndërmarrë çdo veprim për forcimin dhe ruajtjen e paqes ndër fetare në shoqërinë vendase.
- 2.6 BISH është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- 2.7 BISH angazhohet për veprim të pavarur. Veprimtaria e saj nuk mund dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me qëllimet e sipërpërmendura, e as të drejtohet kundër parimeve themelore islame.

3.0 MJETET FINANCIARE

- 3.1 BISH është, në parim, financiarisht e pavarur.
- 3.2 Financimi i BISH sigurohet nga:
 - kontributet e anëtarëve,
 - subvencionet,
 - donacionet e pakushtëzuara,
 - trashëgimitë dhe legatet,
 - kontributet e donatorëve (mbështetësve),
 - të ardhurat nga veprimtaritë dhe organizimet e veta.
- 3.3 Mjetet financiare, si edhe tepricat që rezultojnë nga llogaria vjetore, përdoren në mënyrë të vetme dhe të pakthyeshme për realizimin e qëllimeve dhe synimeve të shoqatës.

4.0 ANËTARËT DHE ANËTARËSIA

- 4.1 Anëtarë të BISH janë personat që i njohin dhe i pranojnë parimet fetare, morale dhe etike të Islamit.
- 4.2 BISH njih:
- a) anëtarë të rregullt
 - b) anëtarë jo të rregullt
 - c) anëtarë nderi
- 4.3 Anëtarësimi në Bashkësinë Islame Shqiptare (BISH) mund të kërkohet në çdo kohë me anë të një kërkesë me shkrim. Vendimin për pranimin e anëtarit e merr Kuvendi i Përgjithshëm.

5.0 KONTRIBUTET E ANËTARËVE

- 5.1 Shuma e kontributeve të anëtarëve përcaktohet nga Kuvendi i BISH.
- 5.2 Kontributet e anëtarëve paguhen çdo muaj ose çdo vit dhe paraprakisht.

6.0 DALJA, PËRJASHTIMI, DORËHEQJA

- 6.1 Anëtarësia përfundon kur:
- një anëtar paraqet me letër rekomande kërkesën e tij për dalje nga shoqata drejtuar Kryesisë;
 - një anëtar përjashtohet, për arsye të pranueshme, me vendim të shumicës prej tre të katërtave të votave të Kuvendit të BISH.
- 6.2 Çdo anëtar mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për përjashtim brenda afatit prej dhjetë ditësh, përmes një kërkesë me postë të rekomanduar. Në këtë rast, vendimin përfundimtar e merr Këshilli Mbikëqyrës i BISH. Vendimi i këtij organi është përfundimtar.
- 6.3 Anëtarët që dalin ose përjashtohen nga BISH nuk kanë asnjë të drejtë pretendimi mbi pasurinë e shoqatës.

7.0 ORGANIZIMI

- 7.1 Organet e BISH janë:
- Kuvendi
 - Kryesia
 - Këshilli Mbikëqyrës i BISH

8.0 KUVENDI

- 8.1 Kuvendi është organi më i lartë i BISH. Ai thirret një herë në vit në mbledhje të rregullt.

- 8.2 Kuvendi ka këto detyra:
- Zgjedhjen e Këshillit Mbikëqyrës të BISH,
 - Përcaktimin e shumës së kontributeve të anëtarëve,
 - Rishikimin dhe ndryshimin e Statutit.
- 8.3 Vendimet merren me shumicë absolute të votave të të pranishmëve.
- 8.4 Kuvendi është i vlefshëm për marrjen e vendimeve kur arrihet kuorumi prej dy të tretash të anëtarëve. Nëse kuorumi nuk arrihet, Kuvendi thirret përsëri dhe, në këtë rast, ai konsiderohet i vlefshëm për vendimmarrje, pavarësisht numrit të të pranishmëve.
- 8.5 Kuvendi zhvillohet në gjuhën shqipe, por pjesërisht edhe në një nga gjuhët zyrtare të Zvicrës.
- 8.6 Pikat e rendit të ditës duhet të bëhen të njohura më së voni një javë para mbajtjes së Kuvendit.

9.0 KRYESIA

- 9.1 Kryesia përbëhet nga: kryetari, nënkryetari, dy sekretarët, dy arkëtarët, kontabilisti, dy anëtarë të kryesisë, si dhe imami, i cili merr pjesë si anëtar konsultativ pa të drejtë vote.
- 9.2 Kryesia zgjidhet çdo katër vjet. Rizgjedhja është e mundur.
- 9.3 Anëtarët që zgjidhen rishtazi në Kryesi duhet të kenë qenë anëtarë të BISH për së paku dy vjet para zgjedhjes së tyre.
- 9.4 Kryesia i drejton punët e BISH dhe i zbaton vendimet e Kuvendit.
- 9.5 Kryesia ushtron detyrën në mënyrë vullnetare; kjo do të thotë se të gjitha punët e kryera nga anëtarët e saj nuk shpërblehen financiarisht.
- 9.6 Anëtarët e Kryesisë mund ta paraqesin dorëheqjen e tyre duke respektuar një afat njoftimi prej tre muajsh, me efekt në fund të muajit, përmes një kërkesë të dërguar me postë të rekomanduar drejtuar kryetarit të Kryesisë.
- 9.7 Është në kompetencën e Kryesisë që, në rastet e parashikuara në pikën 9.6, të thërrasë një Kuvend të Jashtëzakonshëm të me qëllim zgjedhjen e anëtarit ose anëtarëve zëvendësues.

10.0 KËSHILLI MBIKËQYRËS

- 10.1 Kuvendi e zgjedh Këshillin Mbikëqyrës të BISH për një mandat katërvjeçar. Ky këshill përbëhet nga të paktën tre persona. Rizgjedhja e tyre lejohet vetëm një herë.
- 10.2 Anëtarët që zgjidhen rishtazi në Këshillin Mbikëqyrës duhet të kenë qenë anëtarë të BISH për të paktën dy vjet para zgjedhjes së tyre.
- 10.3 Detyrat themelore të Këshillit Mbikëqyrës janë me karakter këshillues dhe mbikëqyrës në raport me Kryesinë dhe me komisionet apo organet e tjera të BISH.

- 10.4 Nëse Këshilli Mbikëqyrës konstaton parregullsi ose mospërputhje në punën e Kryesisë apo të ndonjë komisioni tjetër dhe nuk arrihet marrëveshje me organin përkatës, ai ka të drejtë ta thërrasë Kuvendin dhe t'i informojë anëtarët mbi vërejtjet e tij. Kuvendi vendos më pas për hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren.

11.0 MBAJTJA E LLOGARIVE

- 11.1 BISH mban regjistrim kontabiliteti për të gjitha fushat e saj të veprimtarisë financiare.
- 11.2 Regjistrat financiarë duhet t'u paraqiten, më së voni një muaj para mbajtjes së Kuvendit, kontrolluesve të llogarive, të caktuar nga Kryesia.
- 11.3 Kontrollimi i llogarive kryhet nga dy kontrollues financiarë (revizorë); këta revizorë nuk duhet të jenë anëtarë të Kryesisë apo të Këshillit Mbikëqyrës të BISH.
- 11.4 Raporti i kontrolluesve financiarë (revizorëve) duhet t'i paraqitet Kuvendit për miratim ose refuzim.

12.0 PËRFAQËSIMI NDAJ PALËVE TË JASHTME

- 12.1 BISH përfaqësohet ndaj palëve të jashtme, në parim, nga kryetari; në rast pengese të tij, përfaqësimi kryhet nga nënkryetari.
- 12.2 Nënshkrimet e përbashkëta të kryetarit dhe arkëtarit, ose të nënkryetarit dhe arkëtarit, e obligojnë BISH në lidhje me çështjet e rregullta të veprimtarisë.

13.0 PËRGJEGJËSIA JURIDIKE

- 13.1 Për detyrimet e BISH përgjegjëse mbahet vetëm pasuria e saj.
- 13.2 Përgjegjësia personale e anëtarëve është e përjashtuar.

14.0 SHPËRBËRJA

- 14.1 Me vendim të shumicës prej tre të katërtave të anëtarëve, BISH mund të shpërbëhet në një mbledhje të rregullt ose të jashtëzakonshme të Kuvendit.
- 14.2 Në rast shpërbërjeje të shoqatës, çdo pasuri e mbetur duhet t'i kalojë një shoqate humanitare islame në Zvicër, e cila gëzon përjashtim nga tatimi.

15.0 NDRYSHIMI I STATUTIT

- 15.1 Ky statut mund të ndryshohet me shumicën prej dy të tretash të votave të Kuvendit. Kërkesa për ndryshim të statutit mund të parashtrohet nga shumica absolute e Kryesisë ose e Këshillit Mbikëqyrës të BISH. Kërkesa duhet të jetë përfshirë paraprakisht në listën e rendit të ditës.

15.2 Nëse në Kuvend nuk marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve me të drejtë vote, atëherë thirret një Kuvend i Jashtëzakonshëm dhe vendimi merret në përputhje me nenin 8.4 të këtij statuti.

15.3 Çdo ndryshim i statutit, pas miratimit, hyn në fuqi menjëherë.

16.0 JURIDIKSIONI: Vendi i juridiksionit është Kreuzlingeni / TG.

Kryetari: Xhaferi Faredin

Sekretari: Halili Besir

Kreuzlingen, më 10.03.2019